



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 28 shkurt 2018, në mbledhjen e III (tretë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës së Podujevës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi pjesëmarrjen, dhe shtoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj se e keni marrë të gjithë me kohë, me pikat e rendit të ditës jeni të njoftuar po ashtu të gjithë, andaj pa humbur kohë mund të fillojmë me punë, ftoj Komisionin për verifikimin e mandateve të bëj verifikimin e mandateve të dy këshilltarëve të ri të Kuvendit, përkatësisht z.Afrim Shabani i cili zëvendëson ish këshilltarin z.Faik Muçiqi tani më i emëruar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - DSHPMSh, dhe z.Benjamin Ejupi i cili zëvendëson ish këshilltarin z.Esat Ejupi i cili për arsye personale ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e këshilltarit të Kuvendit të Komunës. Edhe njëherë ftoj komisionin në fjalë i cili përbëhet nga z.Avni Fetahu, Doruntina Hasani dhe Fatmir Rudari të procedojnë me këtë çështje, dhe të paraqesin raportin përkatës.

Pas verifikimit të mandatit të dy këshilltarëve të rinj, nga ana e Komisionit, paraqitet raporti, si vijon.

z.Avni Fetahu, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve, theksoi, Komisioni për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve, përkatësisht Certifikimit të rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve për Kuvendin e Komunës, vendimeve përkatëse për zëvendësim si dhe dokumentacionit të dorëheqjes nga pozita e këshilltarit të Komunës së Podujevës z.Faik Muçiqi nga radhët e LDK-së për të marrë detyrën e drejtorit të DSHPMSh, si dhe dorëheqjes së z.Esat Ejupit nga pozita e këshilltarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në renditje nga lista e certifikuar e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale të viti 2017, për të marrë detyrën e këshilltarit të Kuvendit të Komunës janë këshilltarët, si në vijim: z.Afrim Shabani nga radhët e subjektit politikë LDK dhe z.Benjamin Ejupi nga radhët e subjektit PD.

Kryesues i Kuvendit, falënderoi Komisionin, dhe fton z.Afrim Shabanin dhe z.Benjamin Ejupin të ngritën në këmbë për dhënien e Betimit, sipas procedurave unë e lexoj tekstin me zë kurse ju e përsëritni atë, me të vetmin plotësim që në fillim e theksoni emrin dhe mbiemrin e Juaj.

Këshilltarët e lartpërmendur, me tekstin si në vijim japën Betimin solemn,

Unë, (Afrim Shabani respektivisht Benjamin Ejupi), betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltarë e Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, konstatojmë se tani e tutje z.Afrim Shabani dhe z.Benjamin Ejupi edhe zyrtarisht janë këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë ligjore, urime, ju dëshiroj shëndet, suksese dhe punë të mbarë. Tani mund të fillojmë me punë sipas rendit të propozuar të ditës, a pajtoheni me këtë rend të ditës.

Rendi i Ditës

U konstatua se njëzëri u miratua rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës:

- Mbledhja inauguruese e mbajtur më 20 dhjetor 2017, dhe
- Mbledhja e jashtëzakonshme e mbajtur më 18 janar 2018.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket kësaj pike, para vetës kemi dy Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara. Fillimisht sa i përket Ekstraktit nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 18 janar 2018, në faqen 3 (tre) tek biografia ime ku thuhet “*është lindur më 10.08.1953*” kërkoj të korrigjohet si vijon “*është lindur më 08.10.1953*” sepse kjo është datëlindja ime, si dhe në vazhdim ku thuhet “*mbrojtje civile dhe emergjenca*” të korrigjohet si vijon, “*mbrojtje dhe siguri*”, pra mund të jenë përvjedhur këto dy gabime të cilat i konsideroj teknike, andaj edhe kërkoj të korrigjohen.

Nëse ndokush nga Ju këshilltarët ka ndonjë vërejtje apo plotësim-ndryshim në Ekstrakte, mund të merre fjalën, nëse jo i hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan:

- Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e mbajtur më 20 dhjetor 2017, dhe
- Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e mbajtur më 18 janar 2018, me korrigjimin e gabimit teknik, kërkuar nga Kryesuesi i Kuvendit.

2. Themelimi i Komiteteve të përshërshme të Kuvendit të Komunës:

- Komiteti për Politikë dhe Financa
- Komiteti për Komunitete

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ju njoftoj se kemi pasur takime jo formale me disa prej përfaqësuesve të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë përbërje të Kuvendit, përkatësisht me z.Bajram Ajetin nga LVV-ja dhe me z.Rafet Llapashticën nga PDK-ja, rreth themelimit të këtyre komiteteve.

Sigurisht që shumica prej këshilltarëve jeni në dijeni se në përbërje të Komiteteve duhet të respektohet përfaqësimi gjinor 50% për të dy gjinitë, gjë e cila është konfirmuar edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL me disa prej vlerësimeve të ligjshmërisë të vendimeve përkatëse të Komunave ku vlerësimet kanë qenë në kundërshtim me ligjin, andaj kërkoj

që kjo të përfilllet nga ana e këtij Kuvendi përkatësisht nga propozuesit e anëtarëve në këto dy Komitete. Gjithashtu në materialin e dërguar jeni informuar rreth përbërjes, numrit të anëtarëve dhe çështjeve tjera sa i përket këtyre Komiteteve. Kryesuesi i Kuvendit shkon me automatizëm dhe është edhe Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF, gjë e cila zbatohet edhe në Kuvendet e Komunave tjera të Republikës së Kosovës, kurse anëtarët tjerë për KPF duhet të plotësohen nga përbërja e Kuvendit. Për Komitetin për Komunitete jemi përcaktuar për 9 anëtarë ku shumica duhet të jetë nga komunitetet jo shumicë që i bie 5 përfaqësues, dhe 4 anëtar nga radhët e përbërjes së Kuvendit, andaj pa humbur kohë ftoj përfaqësuesit e subjekteve të marrin fjalën rreth strukturës, formulës së përfaqësimit dhe propozimit të emrave në këto dy Komitete.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në propozimin për strukturën e Komiteteve që na është dërguar me materialin e kësaj mbledhje, në fund është deklaruar neni 6.5 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr.03/2014, e që dua të them se nuk është paraparë përfaqësimi gjinorë 50% që Kryesuesi e tha në fjalën hyrëse. Unë mendoj se do të ishte mirë të jetë përfaqësimi gjinorë 50%, po të ishte ashtu, por megjithatë unë jam që të respektohen ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore në fuqi të cilat i referohen pushtetit lokal, andaj meqë edhe vet Ju në material e keni deklaruar se *përfaqësimi gjinor në Komitetet e Përhershme duhet të jenë në proporcion të përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Komunës*, e ai përfaqësim është 30%, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, edhe pse jemi për përfaqësim gjinorë 50%, nuk mendojmë se janë përmbushur kushtet për një gjë të tillë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për informim, ne kemi pasur takime me përfaqësuesit e Ministrive përkatëse rreth kësaj çështje ku nga Kryesuesit e Kuvendeve decidivisht është kërkuar të respektohet ligji për barazi gjinore përkatësisht përfaqësimi gjinor 50%, në të kundërtën ashtu siç u janë kthyer vendimet përkatëse për rishqyrtim disa Komunave, në një mënyrë na është thënë se do të veprojmë njëjtë edhe me Komunitat tjera të cilat ende nuk i kanë themeluar Komitetet në fjalë. Unë në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit nuk do të këmbëngulë sepse nuk kam as të drejtë të kërkoj që me çdo kusht të përfilllet një gjë e tillë, mirëpo jam i obliguar t'ju njoftoj dhe të kërkoj që vendimet të merren në harmoni me legjislacionin në fuqi. Shumica prej Kryesuesve të Kuvendeve komunale, në atë takim kanë kërkuar që të respektohet legjislacioni përkatës që ka të bëjë me funksionimin e pushteti lokal sepse në disa raste ka diskrepancë mes ligjeve dhe akteve nënligjore, që në një formë e ceku edhe parafolësi, por si do që të jetë mendoj se dispozitat ligjore që rregullojnë përfaqësimin gjinor 50% duhet të respektohen dhe jam që të respektohen.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, si konfuzion kemi ndeshjen mes ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, mirëpo juridikisht bazën e qëndrueshme e ka ligji i fundit i miratuar i cili i referohet një çështjeje dhe për këtë sigurisht se do të ketë debate sepse Ligji për zgjedhjet e thotë ndryshe, Udhëzimi Administrativ ndryshe dhe Ligji për barazi gjinore ndryshe, do të thotë se fuqinë ligjore e ka ligji i fundit i miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës e që është Ligji për barazi gjinore, kështu që Kryesuesi i Kuvendit duhet ta sqaroj këtë çështje dhe të themelohen këto trupa të Kuvendit dhe të kompletohet edhe Ekzekutivi sepse mendoj se jemi vonuar në këtë aspekt. Po ashtu edhe subjektet politike të përfaqësuara në këtë Kuvend duhet të kenë vëmendje në këtë aspekt sepse ligjshmërinë e vendimeve e vlerëson MAPL-ja, andaj mbetet përgjegjësi e jona si Kuvend se si të veprojmë sa i përket përfaqësimit gjinorë në Komitete, 50% sipas ligjit apo 30% sipas Udhëzimit Administrativ, e që sërish e përsërisë se fuqinë juridike e ka ligji i fundit i miratuar. Kryesuesi i Kuvendit të vendosë se si të veprojmë sepse në një formë ai është përgjegjës të orientoj Grupet politike se si të veprojmë, pastaj të presim vlerësimet e ligjshmërisë nga Ministria përkatëse.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë e përsërisë se ne Kryesuesit e Kuvendeve kemi pasur dy takime me përfaqësues të Ministrive ku rreth kësaj çështje na është

thënë se në raste se nuk përfillet përfaqësimi gjinorë 50% për të dy gjinitë, që Ligji për barazi gjinore e përcakton ashtu, Ministria do të vlerësoj ato vendime si të kundërligjshme, gjë e cila ka ndodhur në shumë Komuna tjera. Unë e mbështesë përfaqësimin gjinorë 50% sepse nuk dëshiroj që vendimet e këtij Kuvendi të kthehen dhe të vlerësohen si jo në harmoni me ligjin.

z.Bajram Ajeti, theksoi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kompetenca vetëm për ligjet dhe aktet nënligjore të cilat i sponsorizon ajo vetë, kurse Ligji për barazi gjinore është ligj i përgjithshme dhe vlen për çdo subjekt juridik qoftë në sektorin publik qoftë në sektorin privat, kështu që e thash dhe po përsëris që çështja e përfaqësimit gjinorë në këto Komitete është dashtë të sqarohet në materialin e dërguar për këtë mbledhje, e jo vetëm të figuroj një nen i një Udhëzimi Administrativ në atë material. Për ne LVV-në nuk paraqet aspak problem përfaqësimi gjinor, madje ne jemi që gjinia femërore të jetë e përfaqësuar 70%, por problemi është që nuk i është vënë kujdes i mjaftueshëm kësaj çështje para se të hymë në mbledhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë, nga përfaqësues të MAPL-së në takime na është thënë se përfaqësimi gjinor 50% për të dy gjinitë duhet të filloj diku, e pikërisht kemi vendos që të filloj nga themelimi i Komiteteve të Kuvendeve të Komunave, përndryshe të gjitha vendimet do të kthehen mbrapa për arsye të mos respektimit të dispozitave të Ligjit për barazi gjinore, andaj mos të humbim kohë me përsëritje të debateve por të vazhdojmë me dhënien e propozimeve.

z.Avni Fetahu, theksoi, pas sqarimeve të dhëna nga Kryesuesi i Kuvendit, por edhe duke marrë për bazë ato çka kemi parë nga mediat rreth vlerësimeve të ligjshmërisë së vendimeve të tilla, si të jashtëligjshme, të një numri të Kuvendeve të Komunave si pasoj e mos respektimit të dispozitave të Ligjit për barazi gjinore, konsideroj nuk kemi çka diskutojmë kaq gjatë për një çështje e cila është e rregulluar mjaft qartë. Duke pasë parasysh rëndësinë e themelimit të Komiteteve të përhershme, përgjegjësitë dhe detyrat që kanë këto Komitete, nga Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, për anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, propozohen;

Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu dhe unë Avni Fetahu.

Ndërsa për anëtarë në Komitetin për Komunitete propozohen;

Benjamin Ejupi dhe Vabona Kadriu - Podvorica

z.Fitim Haziri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, për anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, propozohen;

Fitim Haziri, Adelinë Stublla dhe Vendenis Lahu

Ndërsa për anëtar në Komitetin për Komunitete, propozohet;

Doruntina Hasani

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket parafolësit i cili propozoj tre anëtar për Komitetin për Politikë dhe Financa, mendoj se në bazë të përqindjes së këtij subjekti dhe ulëseve në Kuvend, nuk mendoj se i takojnë tri vende, por sido që të jetë është propozim dhe mund të debatojmë rreth formulës për përfaqësim në këtë Komitet.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, është mirë që Kryesuesi i Kuvendit të na orientoj rreth formulës dhe përfaqësimit në KPF. Për dallim nga mandati i kaluar ku KPF përbëhej prej 11 anëtarëve, tani në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës KPF i Kuvendit të Komunës së Podujevës duhet t'i ketë 9 anëtar. Ne faktikisht e dimë përqindjen përkatësisht formulën ku si shembull, nëse në bazë të përqindjes një subjekt del 1.5 automatikisht duhet të përfaqësohet me dy anëtar, pastaj pa pasur Grup të këshilltarëve i cili përbëhet tre e më shumë, nuk mund të ketë përfaqësues në KPF. Pra Kryesuesi të na sqaron dhe orientoj më shumë rreth formulës dhe numrit të ulëseve të subjekteve politike në mënyrë që të vazhdojmë me propozime, në të kundërtën kjo pikë do të zgjatë pafund me diskutime. Në fakt, LVV propozoj 3 anëtar, LDK-ja propozoj 4, mandej Kryesuesi me

automatizëm, bëjnë 8 anëtarë, edhe ne PDK kemi vendos për 2 anëtarë e që konsideroj se na takojnë, po bëjnë 10 gjithsejtë, e që tejkalohet numri. Pra Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik PDK, në bazë të përqindjes dhe numrit të ulëseve në Kuvendin e Komunës na takojnë të paktën 2 anëtarë sepse po të pjesëtohet proporcionalisht rezultati del 1.7, andaj kërkoj nga LDK-ja dhe LVV-ja që njëra prej tyre ta tërheq një anëtarë të propozuar në mënyrë që ky proces të përfundoj.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e kam analizuar Udhëzimin Administrativ i cili rregullon themelimin dhe përbërjen e Komiteteve të përhershme në Komuna dhe kemi pasur shumë takime dhe konsulta në mandatin e kaluar rreth kësaj çështje, andaj dëshiroj të jap disa sqarime.

Sa i përket formulës së përfaqësimit të subjekteve politike në Komitetin për Politikë dhe Financa, Komuna e Podujevës duhet t'i ketë 9 anëtarë/e duke përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit i cili dihet por është e rregulluar edhe me ligj se shkon me automatizëm, do të thotë nuk numërohet por është sipas detyrës zyrtare, dhe mbesin 8 vende – anëtar të cilët duhet t'i zgjedh ky Kuvend.

Nëse numri prej 35 këshilltarëve të Kuvendit përpjesëtohet me 8 anëtarë që duhet të zgjedhën del që për një anëtar në KPF, një Grup i këshilltarëve duhet të ketë të paktën 4.37, dhe nëse merret parasysh kjo formulë, LDK duhet të ketë 4 anëtarë sepse nga 16 përpjesëtimi del 4, LVV duhet të ketë 2 anëtarë sepse janë 8 këshilltarë/e dhe në përpjesëtim me 4.37 rezultati është 2, dhe PDK duhet të ketë 2 anëtarë sepse në përpjesëtim me 4.37 rezultati është mbi 1.6, formulë kjo e cila besoj se është reale dhe e arsyeshme.

Rreth përfaqësimit në Komitetin për Komunitete, po ashtu rregullohet me të njëjtin Udhëzim Administrativ i cili sa i përket përfaqësimit gjinorë thotë se duhet të jetë 30%, çështje të cilën e ceku edhe këshilltari z.Bajram Ajeti, mirëpo një çështje duhet theksuar se ligji është më i fuqishëm se sa aktet nënligjore, andaj sa i përket përfaqësimit gjinorë mendoj se duhet zbatuar Ligji për barazi gjinore i cili parasheh përfaqësim 50% për të dy gjinitë. Lidhur me formulën e përfaqësimit në Komitetin për Komunitete, me dispozita ligjore parashihet që në kuadër të përbërjes së këtij Komiteti shumica duhet të jetë nga Komunitetet jo shumicë, që i bie 5 përfaqësues nga Komunitetet dhe 4 përfaqësues nga përbërja e Kuvendit ku nga këta sipas përqindjes së përfaqësimit të subjekteve politike në Kuvend del që LDK duhet t'i propozoj dhe t'i ketë 2 anëtarë, nga një prej dy gjinive, si dhe rekomandoj edhe subjektet tjera që me rastin e dhënies së propozimeve të respektojnë këtë formulë dhe përfaqësimin gjinor 50% për të dy gjinitë.

z.Fitim Haziri, theksoi, meqë Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga 9 anëtarë e jo nga 8 ashtu siç u tha, atëherë nëse përpjesëtohet numri prej 35 këshilltarëve sa janë në Kuvend rezultati del rreth 3.88. Kryesuesi i Kuvendit nuk është i pavarur por i takon një subjekti politik, mirëpo nëse ai jap dorëheqje nga LDK-ja ne sigurisht që e pranojmë, kurse nëse LDK ka 15 ulëse del që duhet të ketë 4 anëtarë në KPF duke përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se tani më u sqaruam rreth numrit të anëtarëve në KPF, përfaqësimit gjinorë dhe formulës proporcionale që duhet të përfaqësohen subjektet politike. Pa dashur të jem subjektiv, konsideroj se formula më e mirë e përfaqësimit në KPF është ajo që u cekë nga këshilltari z.Mehmet Gashi, pra Kryesuesi i Kuvendit me automatizëm, LDK - 4 anëtar (nga 2 të dy gjinive), LVV - 2 anëtarë (nga 1 anëtarë të dy gjinive) dhe PDK - 2 anëtarë po ashtu (nga 1 anëtarë të dy gjinive), përfaqësim ky të cili është më real, më i mundshmi dhe më i përfaqësuar, andaj nëse nuk ka të interesuar për të marrë fjalën, do ta hedhja në votim këtë strukturë.

Pas votimit u konstatua se me 25 vota për, 9 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua propozimi që struktura e dhe përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa të jetë kështu;

*Kryesuesi i Kuvendit me automatizëm,
LDK - 4 anëtarë, (2 femra – 2 meshkuj),
LVV - 2 anëtarë (1 femër – 1 mashkull) dhe
PDK -2 anëtarë (1 femër – 1 mashkull)*

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së ka propozuar emrat e anëtarëve për KPF, Grupi i këshilltarëve të LVV-së ka propozuar 3 emra andaj duhet ta tërheq një emër të propozuar, ndërsa nga Grupi i këshilltarëve të PDK kërkohet të propozoj emrat.

z.Fitim Haziri, theksoi, meqë propozimi për strukturën e Komitetit për Politikë dhe Financa mori mbështetjen e shumicës, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së tërheq një emër të propozuar më parë, përkatësisht emrat e propozuar mbeten në Fitim Haziri dhe znj.Adelinë Stublla, ndërsa për Komitetin për Komunitete mbetet e propozuar znj.Doruntina Hasani.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së për anëtar/e në Komitetin për Politikë dhe Financa propozohen znj.Floretë Zejnullahu dhe unë Rafet Llapashtica, ndërsa për anëtar në Komitetin për Komunitete propozohet z.Bashkim Sylja.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, ne të gjithë jemi në dijeni se përbërjet e komiteteve janë me numra tek, andaj është e pamundshme të ndahet përfaqësimi gjinor 50% për të dy gjinitë, mirëpo kjo sigurisht është e sqaruar nga ana e Ministrisë përkatëse se në rast se komiteti përbehet prej 9 anëtarëve atëherë 4 duhet të jenë femra dhe 4 meshkuj dhe Kryesuesi ose Kryesuesja i/e Kuvendit që shkon me automatizëm, pra llogaritet vetëm përbërja duke mos u përfshirë Kryesuesi/ja.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, unë e hedh në votim themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, sipas strukturës së mbështetur dhe emrave të propozuar nga Grupet e këshilltarëve të Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se njëzëri, me 35 vota për, u miratua propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në këtë përbërje:

1. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht Kryesues i KPF-së
2. Mehmet Gashi, anëtar nga radhët e LDK-së
3. Fatlume Jaha, anëtare nga radhët e LDK-së
4. Arlinda Kadriu, anëtare nga radhët e LDK-së
5. Avni Fetahu, anëtar nga radhët e LDK-së
6. Fitim Haziri, anëtar nga radhët e LVV-së
7. Adelinë Stublla, anëtare nga radhët e LVV-së
8. Rafet Llapashtica, anëtar nga radhët e PDK-së
9. Floretë Zejnullahu, anëtare nga radhët e PDK-së

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani në radhë kemi nën pikën për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete. Ju informoj se edhe për këtë Komitet jemi dakorduar që të përbëhet prej 9 anëtarëve ku prej tyre 5 anëtarë/e duhet të jenë nga Komunitetet jo shumicë dhe 4 anëtar/e nga përbërja e Kuvendit të komunës.

Unë me të marrë detyrën e Kryesuesit të Kuvendit kam kërkuar përkatësisht ju kam bërë ftesë me shkrim Komuniteteve që të organizohen të mbajnë takime dhe në formë të shkruar me procesverbal të sjellin propozimet - përfaqësuesit e tyre në Komitetin për Komunitete.

Komuniteti Ashkalinj i ka sjellë në formë të shkruar emrat e kandidatëve të propozuar, siç janë; Shaban Ahmeti, Xhafer Ademi dhe Valmira Lahu.

Gjithashtu Komuniteti Rom ka sjellë emrin e propozuar, ai është Mefail Rama.

Nga Komuniteti Serb është sjellë si propozim Radisav Perović, i cili është anëtar i këtij Komiteti pothuajse që nga themelimi, ndërsa nga përbërja e Kuvendit, edhe pse disa prej emrave u propozuan, kërkoj të propozohen sërish.

z.Avni Fetahu, theksoi, siç e potencuam edhe më parë, në Komitetin për Komunitete, nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së, propozohen znj.Valbona Kadriu – Podvorica dhe z.Benjamin Ejupi

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së u propozua znj.Doruntina Hasani, ndërsa nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së u propozua z.Bashkim Sylja.

Pra edhe për Komitetin për Komunitete tani më kemi emrat e propozuar, andaj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo mund ta hedhim në votim edhe themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket Benjamin Ejupit të cilin e propozoi Grupi i LDK-së, Rregullorja e thotë që përfaqësimi në Komitete nga anëtarët të cilët nuk kanë Grup të këshilltarëve nuk mund të bëhet, prandaj do të ishte mirë që i përmenduri të deklarohet se a kalon nga subjekti Partia e Drejtësisë në Grupin e këshilltarëve të LDK-së, përndryshe ky propozim proceduralisht në bazë të Rregulloreve është i paligjshëm apo në kundërshtim me Rregulloret e Kuvendit të Komunës. E them këtë për arsye se në përbërjen e këtij Kuvendi kemi edhe këshilltarin e Kuvendit z.Patriot Rudari nga radhët e AAK-së dhe z.Avni Islamin nga subjekti OBKD, këshilltarë këta që nuk kanë grup të këshilltarëve, por që neve nuk na ndalohej që t'i propozojmë, mirëpo ne duhet të veprojmë në pajtim me Rregulloret e Kuvendit të Komunës që thuhet se nuk mund të ketë përfaqësim në dy Komitete obligative pa pasur grup të këshilltarëve, prandaj edhe njëherë e përsëris që Benjamin Ejupi duhet të kaloj në radhët e Grupit të këshilltarëve të LDK-së pastaj të vazhdojmë me votim. Nuk kemi asgjë kundër Benjamin Ejupit, dhe ne do ta votojmë këtë përbërje sipas propozimeve të bëra, por vetëm dëshiroj të mos marrim vendime të cilat mund të jenë në kolizion ligjor me Rregulloret e Kuvendit të Komunës, pra të mos keqkuptohemi, por këshilltari i cekur ose të kaloj nga Partia e Drejtësisë në Lidhjen Demokratike të Kosovës ose kjo e fundit të propozoj një këshilltar tjetër nga radhët e saj.

z.Bajram Ajeti, theksoi, ne si Kuvend paraprakisht u pajtuam që përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa të jetë 50% për të dy gjinitë, të njëjtat dispozita ligjore vlejnë edhe për Komitetit për Komunitete, kurse tani në bazë të propozimeve të dhëna del se nuk po respektohet përfaqësimi gjinor sa i përket përbërjes së Komitetit për Komunitete, prandaj në bazë të qëndrimeve të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit unë mendoj se ky Komitet nuk është i gatshëm të miratohet sot. Do të ishte mirë që të paktën LDK-ja të propozonte dy femra në këtë Komitet por ja që z.Benjamin Ejupi paska hy në pazare të LDK-së dhe kemi këtë situatë. Sa i përket asaj që parafolësi e tha që këshilltari i cekur duhet të deklarohet për pozicionin e tij në këtë Kuvend, mendoj se ai nuk mund as të deklarohet e as të kaloj në LDK sepse të paktën duhet të ketë anëtarësim pastaj duhet të ketë një librezë dhe të ketë një status si anëtar i LDK-së, kështu që me deklaram nuk mund të bëhet një gjë e tillë, por do të ishte mirë që këto pazare të marrin fund një ditë.

Pra nëse ne me përbërjen e Komitetit për Komunitete nuk po respektojmë vendimin tonë që paraprakisht e morëm me rastin e Komitetit për Politikë dhe Financa, rreth përfaqësimit gjinorë 50%, mendoj se themelimi dhe përbërja e Komitetit për Komunitete nuk është i gatshëm për sot, nëse dëshirojmë të jemi parimorë sa i përket respektimit të ligjeve dhe procedurave mund ta bëjmë një të tillë andaj kërkoj të bisedohet mes vete nga përfaqësuesit e Grupeve të këshilltarëve në mënyrë që të gjendet një zgjidhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sqarim rreth përbërjes dhe formimit të komitetit për Komunitete, ne kemi bërë përpjekje në maksimum dhe krejt çka është mund të nxjerrët tek komunitetet jo shumicë është që nga komuniteti Ashkalinj është propozuar një femër gjë të cilën kemi insistuar me çdo kusht që të ketë një femër, ndërsa këto dy komunitetet tjera nuk kanë mundur të sigurojnë përfaqësues tjerë. Sa i përket Grupeve të këshilltarëve të tri subjekteve të Kuvendit LDK, LVV, PDK, unë mendoj se po përfaqësohen ashtu siç është më së miri në Komitetin në fjalë, ndërsa rreth përfaqësimit, qoftë gjinor qoftë aspekte tjera të Komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, të mbetet përgjegjësi e tyre sa i përket të propozuarve për anëtar/e në Komitetin për Komunitete.

Sa për deklarin e z.Benjamin Ejupit, mendoj se është mirë që të del në foltore dhe të deklarohet se është pjesë e Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, nuk ka asgjë për të fshehur këtu sepse ka një marrëveshje mes dy subjekteve politike e cila ka qenë publike, e jo pazare ashtu siç u tha.

z.Bajram Ajeti, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, në formimin e komiteteve marrin pjesë asambleistët të cilët janë certifikuar nga KQZ-ja, andaj unë mendoj se Ju nuk po arrini ta bindni sot Kuvendin e Komunës se keni bërë përpjekje për të respektuar parimin e barazisë gjinore sa i përket Komitetit për Komunitete. Ne jemi në dijeni se Shaban Ahmeti, Xhafer Ademi janë këtu qysh moti ashtu siç është edhe ai serbi, mirëpo Ju Kryesues duhet të tregoheni më shumë parimorë dhe principiell si dhe të paktën LDK-ja do të duhej të propozonte 2 femra në këtë rast, përndryshe nëse fillojmë me deklarime se kush cilit grup të këshilltarëve i takon, po bëjmë lojëra dhe po e humbim seriozitetin si asambleistë. Edhe një herë e përsërisë dhe kërkoj që themelimi dhe përbërja e këtij Komiteti të shtyhet, e them këtë sepse në rastin e përbërjes së KPF-së ishte vet Kryesuesi i Kuvendit ai i cili kërkoj të respektohet ligji për barazi gjinore me arsyetim se në qoftë se vendimet merren në kundërshtim me dispozita ligjore, MAPL do t'i kthej ato, andaj përse të bëjmë një veprim të tillë duke miratuar diçka që bie ndesh me dispozita ligjore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne nuk kemi të drejtë t'ju imponojmë komiteteve jo shumicë se këndë e propozojnë ata për përfaqësim në Komitetin për Komunitete, mirëpo ne kemi bërë përpjekje maksimale që të përfillet përfaqësimi gjinorë 50%, kurse më vie mirë që ne si subjekte politike po e përfillim përfaqësimin gjinorë, por sa i përket propozimeve të Komuniteteve jo shumicë të cilat kanë sjellë vetëm një femër, në rast se vendimi kthehet nga MAPL ne do të bisedojmë me Komunitetet jo shumicë dhe do të kërkojmë që ata të propozojnë edhe një femër në vend të ndonjërit prej meshkujve.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së propozuam dy anëtar, një femër dhe një mashkull, duke marrë parasysh rrethanat që janë të krijuara nga komunitetet tjera, do të ishte mirë që edhe Grupet tjera të këshilltarëve të këtij Kuvendi të reflektojnë.

Sa i përket z.Benjamin Ejupit për të cilin u kërkua të deklarohet se cilit Grup i përket, konsideroj se një gjë e tillë po shihet ashikare dhe nuk është mirë ta ulim diskutimin në gjëra të tilla, madje deri te ajo që marrëveshjet politike të natyrshme, të quhen pazare, si dhe dëshiroj të potencoj se tek ne LDK nuk është bash ashtu obligative që anëtarët të kenë librezë, flamuj etj të ngjashme për tu anëtarësuar.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, duke mos dashur të humbim kohë rreth disa gjërave sepse një pjesë e këshilltarëve të Kuvendit janë të rinjë në këtë pozitë dhe ndoshta e kanë më të vështirë në disa çështje, por dëshiroj të dijë se a është i njoftuar Kryesuesi i Kuvendit se kush është kryesues i Komitetit për Komunitete, e them këtë sepse ne si Kuvend duhet të marrim vendim andaj edhe duhet të sqarohen këto gjëra sepse për këtë jemi ne këtu. Sa i përket përfaqësimit gjinorë, ne si Kuvend mendoj se në bazë të propozimeve e plotësojmë përfaqësimin gjinor, ndërsa sa i përket propozimeve nga ana e komiteteve jo shumicë, në një formë ne nuk jemi të obliguar t'ju

plotësojmë atyre kuotën gjinore sepse ata janë shumicë në këtë Komitet dhe atyre ju takon Kryesuesi, kurse ne si Kuvend duhet ta dimë se kush është kryesues dhe çfarë përgjegjësisë ka ai ashtu siç jemi në dijeni për Kryesuesin e KPF-së. Pra ne është dashur të jemi në dijeni se kush është kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe përse ai propozon emra pa e përfillur barazinë gjinore. Ne jemi në dijeni se komunitetet jo shumicë në Republikën e Kosovës i kanë dhe iu respektohen të drejtat e tyre më shumë se në krejt Bashkimin Europian dhe një praktikë e tillë do të respektohet edhe në Komunën e Podujevës, mirëpo për përfaqësimin e barabartë sa i përket gjinisë duhet ta marrin ato komunitete përkatësisht Kryesuesi i atij Komiteti. Asnjëherë në mandatin e kaluar nuk e kam parë kryesuesin e atij Komiteti Shaban Ahmetin që të ngritë ndonjë çështje rreth komuniteteve jo shumicë të cilat jetojnë në territorin e Komunës tonë, as nuk kam vërejtur ngritje të cilësisë apo edhe ngritjen e shkollimit të nxënësve të tyre, as përmirësimin e gjendjes sociale dhe të banimit etj, dhe nëse ai nuk e bënë një gjë të tillë, dhe nëse ata e lejojnë Shaban Ahmetin që çdo herë të jetë kryesues i Komitetit për Komunitete, shumë pak edhe mua si këshilltarë i Kuvendit do të më brengosin gjërat e tilla, personalisht po flas, jo në emër të subjektit që i takoj. Në fakt ne jemi të brengosur për gjendjen e komuniteteve jo shumicë në territorin e Komunës së Podujevës, sidomos atyre Rom dhe Ashkalinj, mirëpo edhe ata duhet të ndërmarrin iniciativa dhe të paraqesin kërkesa në këtë Kuvend për të zgjedhur ndonjë problem të tyre, ngase fundja të gjitha subjektet politike kërkojnë vota prej tyre. Edhe njëherë unë si Shef i Grupit të këshilltarëve të PDK-së dëshiroj të di se kush është kryesues i atij Komiteti, dhe mendoj se nuk janë vetëm këta 5 persona të komuniteteve ata që duhet të jenë pa tjetër, por ka vajza dhe djem tjerë të shkolluar me të cilët do të mund të plotësohej përfaqësimi gjinorë edhe nga ana e tyre.

I nderuar Kryesues mere si praktik që të reduktosh sa më shumë debate duke u cekur gjëra të ngjashme dhe në një formë duke u shtyrë mes vete, e di që nganjëherë ndoshta është e vështirë të marrësh vendime, mirëpo praktikojë të hedhën në votim, kaloj nuk kaloj nuk kemi çka të bëjmë. Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e propozuam anëtarin tonë dhe nuk e kemi ndërmend ta ndryshojmë atë propozim vetëm sa për ta përmbushur kuotën gjinore, në çoftë se vendimi kthehet i jashtëligjshëm, t'iu mbetet komuniteteve jo shumicë të përmbushin atë kusht, nëse vlen diçka për komunitetin shumicë duhet të vlejë edhe për atë pakicë ngase ligjet duhet të zbatohen njësoj për të gjithë dhe nga të gjithë, nëse dëshirojmë të ndërtojmë institucione. Shumë pak më intereson emri se kush është në krye të atij komiteti, por mendoj se duhet të jemi shumë transparent për punën e Kuvendit qoftë ndaj qytetarëve qoftë ndaj votuesve tanë, mirëpo nëse Kryesuesi i Kuvendi ose Kryetari i Komunës nuk është në dijeni se kush do ta udhëheq për 4 vitet e ardhshme Komitetin për Komunitete për mua është e palogjikshme, madje nuk po e di se për këndë po votoj, dhe nuk do ta ngriti dorën për dikë që nuk e di paraprakisht se kush është.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për njoftim, zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet në mbledhjen e parë konstituive të këtij Komiteti dhe atë e zgjedhë Komiteti me shumicë të votave, do të thotë që vetë anëtarët e komitetit për Komunitete e zgjedhin Kryesuesin, gjë të cilën ne paraprakisht nuk e dimë se kush do të jetë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ju Kryesues e thatë që propozimet e anëtarëve i kanë sjellë përfaqësuesit e Komuniteteve e që unë mendoj se ato propozime është dashtë të sjellën edhe tek Grupet e këshilltarëve të të gjitha subjekteve LDK, PDK, LVV etj. pra unë po foli për institucionalizëm politik e jo për ngacmueshmëri mes Grupeve politike. Emrat janë propozuar tek ju LDK-ja, kurse tani po kërkohet të votojmë edhe ne subjektet tjera, shembull, i propozuari nga komuniteti Rom Mefail Rama, unë nuk e njoh këtë person dhe nuk di si të votoj për, kur nuk e njoh, ashtu siç nuk e njoh edhe të propozuarin nga komuniteti serb të cilin asnjëherë nuk e kam parë, prandaj si këshilltarë i Kuvendit dorën nuk e ngris vetëm ashtu sa për të votuar, madje jam

kundër sa i përket votimit për një njeri të cilin me shpenzime të Komunës duhet të shkon me veturë në shtëpi të merr për të marrë pjesë në mbledhje, ndërsa ti si Kryesues i Kuvendit nuk ke buxhet as për kafe e gjëra tjera, gjë të cilën unë në emër të PDK-së kam kërkuar të ndahet buxhet për Kryesuesin e Kuvendit si pozitë është fjala e jo si emër, kurse përfaqësuesin e komunitetit serb shkon vozitësi me veturë zyrtare e merr. Pra për këto arsye kërkoj edhe nga të tjerët të votojnë kundër, për këtë formë, ndërsa për forma tjera mund të bisedojmë. Konsideroj se të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve duhet të bashkëpunojnë me Komunën e Podujevës dhe me këtë Kuvend, përndryshe ju mund të votoni për, madje ta ngritni dorën edhe 10-15 vite tjera për ndokënd që nuk e njohim paraprakisht. Po e përsërisë që absolut emrat apo vota tek unë nuk qon peshë, por është përgjegjësi ajo që mbetet sepse njerëzit shkojnë e vijnë, prandaj kjo formë mua më duket e pa orjentuar, nuk do të thotë se është problem i cili nuk mund të zgjidhet, por si do që të jetë sa i përket procedurave unë jam që të kaloj kjo, por duke kërkuar disiplinim të përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë sa i përket detyrave dhe përgjegjësi, dhe këtë e them në emrin tim personal.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, në kuptimin e asaj që u ngrit nga parafolësi, ne duhet ta zbatojmë një Rregullore që i referohet përbërjes së Komitetit për Komunitete, Rregullore në të cilën qartë parashihet numri i anëtarëve të Komitetit dhe përfaqësimi. Ne mund të bëjmë vërejtje, ashtu siç e ceku edhe këshilltari z.Bajram Ajeti, vetëm në përbërjen sa i përket përfaqësimit gjinorë, mirëpo nuk mund t'jua imponojmë komuniteteve se kë e delegojnë ata për t'i përfaqësuar, e njohim apo nuk e njohim si person është pak e rëndësishme, por me rëndësi është që janë të deleguar të komuniteteve. Pra ne mund të bëjmë vërejtje vetëm tek përfaqësimi gjinor që është 50% për dy gjinitë, jam për dhe kërkoj që të respektohet legjislacioni në fuqi që rregullon këtë fushë, ndërsa sa i përket të propozuarve të komuniteteve të caktuara për përfaqësim të tyre në Komitetin për Komunitete të mbetet në përgjegjësi të tyre.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket përfaqësimit gjinor, në këtë komitet duhet të jenë së paku 4 femra dhe 5 meshkuj ose anasjelltas, ne Grupi i këshilltarëve të PDK e japëm propozimin tonë, Grupi i këshilltarëve të LDK-së propozoj një mashkull dhe një femër, dhe nëse Grupi i këshilltarëve të LDK-së ndryshon propozimet përkatësisht nëse propozon dy femra atëherë edhe Grupi i këshilltarëve të PDK-së tërheq propozimin dhe në të njëjtë kohë propozon një femër, dhe arrihet kuota gjinore, nëse jo vendosni si të dëshironi por mos të mbesim duke debatuar mes vete.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, propozoj që ta miratojmë këtë vendim në bazë të propozimeve të bëra, në rast se Ministria vlerëson se vendimi është pa ligjshëm për shkak të mos përfaqësimit të barabartë gjinor, të mbetet çështje e komuniteteve që të ndryshojnë propozimet. Ne si subjekte politike mendoj se kemi përmbushur përfaqësimin gjinorë, andaj nëse pajtoheni ne mund ta hedhim në votim ashtu siç janë propozimet.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se ne në këtë rast me vetëdije po miratojmë vendim të jashtëligjshëm, sepse nuk po respektohet përfaqësimi gjinor 50%, gjë për të cilën mendoj se edhe Kryesuesi i Kuvendit e konsideron si të tillë, e që jam kundër një vendimi të tillë. Pastaj ky vendim mund të merret me shumicë të votave, por është mirë të jemi unik në disa çështje e jo pastaj të dalim me deklarime, jo ai subjekt votoi ashtu jo ky subjekt kështu. Nuk jam kundër themelimit të këtij Komiteti, por këto çështje që i them i bazoj në atë që Kryesuesi e tha vetë se përfaqësimi gjinor duhet të jetë 50% për të dy gjinitë, përndryshe MAPL do të kthej vendimet të jashtëligjshme, dhe tani ai vetë nuk e respekton këtë por dëshiron ta hedh në votim me përbërjen 6 meshkuj dhe 3 femra, ndërsa unë isha për respektimin e kuotës 30% për gjininë femërore qysh në fillim të kësaj pike.

z.Bajram Ajeti, theksoi, emrat për anëtarë të komitetit për komunitete nga komunitetet jo shumicë tani më veç janë dhënë dhe ekzistojnë në zyrë, por mua më intereson të dijë se a kanë sjellë ndonjë procesverbal, a kanë mbajtur komunitetet ndonjë mbledhje apo si janë propozuar ata persona, qoftë Shaban Ahmeti, Xhafer Ademi dhe të tjerët. Pra unë jam që të respektohen ligjet dhe procedurat përkatëse sa i përket zgjedhjes së tyre anëtar të Komitetit, edhe ashtu nuk do të thotë se bëjnë ndonjë punë kush e di sa të madhe në atë Komitet, më shumë është puna për me marrë mëditje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuari Kryesues, konsideroj se subjektet politike në këtë Kuvend e kanë përmbushur kuotën gjinore, përgjegjësia mbetet tek komunitetet jo shumicë që në rast se ky vendim kthehet në kundërshtim me ligjin, ato të bëjnë ndryshime sa i përket propozimeve, përkatësisht të zëvendësojnë një femër me një maqshkull, përndryshe ne Grupi i PDK-së nuk e ndryshojmë propozimin e dhënë. Pra mund të hedhësh në votim këtë përbërje me rekomandim që në rast se vendimi kthehet i jashtëligjshëm, të kërkohet nga komunitetet jo shumicë të propozohet një femër në vend të një mashkulli aktual të propozuar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pajtohem me parafolësin dhe ndajë të njëjtin mendim sa i përket përfaqësimit gjinorë në Komitetin për Komunitete, konkretisht sa i përket propozimeve nga ana e këshilltarëve të Kuvendit është përmbushur përfaqësimi gjinor, kurse nga komunitetet jo shumicë si tërësi, janë propozuar 1 femër dhe 4 meshkuj.

z.Fitim Haziri, theksoi, në bazë të argumenteve që dëgjuam gjatë diskutimeve, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së nuk e votojmë këtë përbërje të Komitetit për Komunitete, ngase konsiderojmë se është i jashtëligjshëm.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket kësaj teme, jemi duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit ngase për të njëjtën çështje po merret fjala më shumë se që përcaktohet me Rregullore, mirëpo këtë e konsideroj si qëllimmirë në mënyrë që të thuhet të gjitha vetëm që të arrihet një vendim i mbështetur nga të gjithë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e kemi dhënë propozimin tonë për anëtar në Komitetin për Komunitete që është z.Bashkim Sylja, andaj edhe vota jonë do të jetë për, ngase çdo votë ndryshe do të rezultonte si votë kundër propozimit të bërë nga vet ne Grupi jonë.

Pra mendoj se situata është e qartë, propozimet janë dhënë, në raste se ky vendim kthehet joligjor, atëherë mbetet që komunitetet jo shumicë të bëjnë propozime të reja duke respektuar përfaqësimin gjinorë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë po thuajse të gjitha diskutimet përfunduan rreth kësaj pike, ne subjektet politike e kemi përmbushur kuotën gjinore sa i përket propozimeve, ndërsa komunitetet jo shumicë nuk e kanë përmbush atë, nëse kërkohet nga MAPL rishqyrtimi i kësaj përbërje për shkak të përfaqësimit gjinorë, mbetet që komunitetet të bëjnë ndryshime në propozimet e tyre. E hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 23 vota për, asnjë votë kundër, 1 votë të përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), u miratua themelimi dhe përbërja e Komitetit për Komunitete, sipas propozimeve të bëra nga Komunitetet jo shumicë dhe atyre të bëra në këtë mbledhje, dhe atë;

- | | |
|--------------------------------|----------------------------------|
| 1. Valbona Kadriu - Podvorica, | anëtare nga radhët e LDK-së |
| 2. Benjamin Ejupi, | anëtar nga radhët e PD-së |
| 3. Doruntina Hasani, | anëtare nga radhët e LVV-së |
| 4. Bashkim Sylja, | anëtar nga radhët e PDK-së |
| 5. Shaban Ahmeti, | anëtar nga komuniteti Ashkalinj |
| 6. Valmira Lahu, | anëtare nga komuniteti Ashkalinj |
| 7. Xhafer Ademi, | anëtar nga komuniteti Ashkalinj |

8. Mefail Rama,
9. Radisav Perović,

anëtar nga komuniteti Rom
anëtar nga komuniteti Serb

3. Themelimi i Komisionit Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës, fjalën e ka kërkuar këshilltari dhe ish Kryesuesi i Kuvendit z.Mehmet Gashi, i cili do të jap arsyetime rreth nevojës për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit.

z.Mehmet Gashi, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim këtë iniciativë. Duke pasur parasysh se Statuti është akti më i lartë juridik i Komunës i cili miratohet nga Kuvendi i Komunës. Me siguri jeni në dijeni se Statuti aktual i Komunës është miratuar në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale në vitin 2009, pastaj ka pasur ndryshim-plotësime në vitin 2012, ndërsa tani për shkak të nxjerrjes së ligjeve të reja dhe akteve nënligjore paraqitet nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit, shembull, në Statut ende figuron që Kuvendi i Komunës ka 41 këshilltarë, ndërsa jemi në dijeni se pas regjistrimit të popullsisë ai numër ka rënë në 35 këshilltarë, pastaj për Komitetit për Politikë dhe Financa figuron që përbëhet nga 11 anëtar kurse me aktet përkatëse nënligjore ai numër ka rënë në 9 anëtar, e gjëra tjera të ngjashme të cilat na obligojnë ta plotësojmë dhe ndryshojmë këtë Statut duke mos përjashtuar edhe ndonjë kërkesë eventuale të Ekzekutivit të Komunës. Andaj nëse vendosim që në kuadër të komisionit të jenë 3 anëtar nga Kuvendi, unë në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së propozoj z.Hasan Ajetin, jurist me profesion.

z.Bajram Ajeti, theksoi, t'ju them të drejtën kur kemi parë këtë pikë në kuadër të thirrje së kësaj mbledhje dhe nuk kishte kurrfarë arsytimi, e që konsideroj se është dashtë të ketë një arsyetim në mënyrë që të njoftohemi përse është e nevojshme plotësimi dhe ndryshimi i Statutit. Këtu nga parafolësi realisht u dhanë vetëm dy çështje që ishin numri i këshilltarëve të Kuvendit dhe numri i anëtarëve të KPF-së mirëpo nuk di sa mund të jetë e vërtetë kjo sepse ka edhe çështje tjera që duhet të rishikohen në Statut, sigurisht jeni në dijeni shumë mirë që është shkëlur edhe Ligji për shëndetësinë dhe shumë çështje tjera të cilat duhet të merret ky komision, mirëpo me kusht që nuk është për tu zgjeruar me ndonjë Drejtori për t'iu plotësuar apetitet disave për tu bërë drejtor që ende nuk janë bërë, përndryshe mendoj se parimisht për ndryshime dhe plotësime ka nevojë në mënyrë që të harmonizohet me legjislacionin në fuqi. Kështu që ne pajtohemi që të formohet komisioni në fjalë dhe sigurisht që do të bëhen ndryshim plotësime të Statutit, por jo diçka që të ketë ristrukturim apo zgjerim të Drejtorive etj etj siç po flitet apo siç dyshohet se do të ndodh, edhe pse është vetëm dyshim e ka arsyen e vet.

z.Fitim Haziri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së, për anëtar në këtë komision propozohet z.Bajram Ajeti.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim reformën dhe harmonizimin e Statutit të Komunës. Për anëtar në këtë komision propozohet z.Arbër Blaku, dhe njëherit kërkojmë që sa më shpejt të mbledhet ky komision dhe të filloj me punë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës parashihi dy anëtarë të cilët propozohen për anëtarë në këtë Komision. Urdhëroni nga Ekzekutivi jepni propozimet.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, këshilltari z.Mehmet Gashi një arsyetim të nevojshëm e dha pse duhet të plotësohet dhe ndryshohet Statuti i Komunës. besoj që të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se nga momenti kur është miratuar dokumenti në fjalë janë ndryshuar shumë

ligje dhe janë nxjerrë shumë akte tjera nënligjore, andaj edhe Statuti i Komunës duhet të jetë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Nuk dëshiroj tani të foli rreth punës së këtij Komisioni, mirëpo ajo që u tha paraprakisht nga këshilltari z.Bajram Ajeti, unë them që mos të kemi frikë nga ky Komision, i cili sot me siguri se do të themelohet, ngase pas plotësimit ndryshimeve, harmonizimeve dhe amandamentimeve të propozuara nga ky Komision, dokumenti final sërish do të sjellët në këtë Kuvend për shqyrtim pas debatit publik që është i obliguar ta organizoj ky Komision, dhe në fund pasi të merren të gjitha sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet e bëra nga debati publik, ato do të sillen në Kuvend për tu miratuar apo jo, pastaj është në kompetencë të këtij Kuvendi të shqyrtoj, miratoj ose jo në tërësi një dokument final. Meqë nga përbërja e Kuvendit u propozuan 3 anëtarë, tani radha është të propozohen edhe 2 anëtarë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, si dhe duke mos harruar që pjesë e këtij komisioni do të jetë edhe Zyra ligjore e Komunës sa i përket mbështetjes dhe ndihmës profesionale në këtë proces. Pra nga Ekzekutivi i Komunës propozohen; z.Faik Muçiqi Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe z.Gëzim Namani Drejtor i Drejtorisë së Administratës.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në gjatë gjithë kësaj seance u paraqitëm shumë për barazi gjinore ndërsa tani kur kemi të bëjmë me formimin e komisioneve të tilla funksionale po dalim nga binarët do të thojë. Unë mendoj se edhe sa i përket formimit të këtij Komisioni do të ishte mirë të përfshihej edhe ndonjë femër në mënyrë që të jenë pjesë e dhënies së kontributit të tyre edhe sa i përket plotësimit ndryshimeve të Statutit, e jo të injorohen, të paktën do të duhej të propozoheshin edhe nga Ekzekutivi i Komunës gjë që do të ishte krejt normale, përndryshe nëse fillojmë të ngrisim komisione të tilla pa përfshirje të gjinisë femërore, po biem ndesh me disa parime dhe qëndrime tonat por edhe me disa vendime të që u morën gjatë kësaj seance. Prandaj numri i anëtarëve mund të rritet edhe për 4 anëtar, 3 prej tyre nga Kuvendi dhe 1 nga Ekzekutivi, është fjala për anëtar nga gjinia femërore në mënyrë që të përmbushet kriteri gjinor.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, në fillimisht kemi menduar që ky Komision të jetë kompakt dhe të takohet sa herë që kërkohet, mirëpo nëse Ju si Kuvend dëshironi, absolutisht nuk paraqet kurrfarë problemi që numri i anëtarëve të rritet nga 5 në 9 anëtar.

Sa i përket asaj që parafolësi e tha se rreth përfaqësimit gjinorë, në fakt po ka raste, që kur një gjë e tillë nuk është e rregulluar me norma ligjore, ndodh të injorohet. Nëse vendosni ta rritni numrin e anëtarëve në këtë Komision, atëherë është mirë që pikërisht parafolësi zotëri Ajeti të filloj përkatësisht të propozoj plus një femër e pastaj edhe subjektet tjera.

z.Bajram Ajeti, theksoi, atëherë meqë po vërejtë disponim për të rritur numrin e anëtarëve të Komisionit, nga Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, propozimit të parë i shtohet edhe këshilltarja znj.Lirika Maliqi.

z.Avni Fetahu, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së, propozimit të parë, që ishte z.Hasan Ajeti i shtohet edhe z.Mrikë Thaqi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së pajtohet për zgjerimin e përbërjes së Komisionit, dhe në propozim përfshihet edhe znj.Endritë Murati.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, faktikisht të gjithë po pajtoheni që komisioni të jetë sa më i kompletuar dhe secili prej anëtarëve të kontribuoj në punë.

Nga Ekzekutivi i Komunës krahas propozimit të dy Drejtorëve propozohet edhe Drejtoresha e DKRS-së znj.Donika Sfishta.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se të gjithë u pajtuan që Komisioni të përbëhet nga 9 anëtarë, 6 nga Kuvendi dhe 3 nga Ekzekutivi i Komunës, po ashtu u dhanë propozimet, andaj mund të hedhim në votim themelimin e këtij Komisioni.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi për Themelimin e Komisionit Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës, sipas propozimeve të dhëna, si vijon:

1. Hasan Ajeti, kryesues nga përbërja e Kuvendit të Komunës
2. Mrikë Thaqi, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës
3. Bajram Ajeti, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës
4. Lirika Maliqi, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës
5. Arbër Blaku, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës
6. Endritë Murati, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës
7. Faik Muçiqi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
8. Gëzim Namani, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
9. Donika Sfishta, anëtare nga Ekzekutivi i Komunës

4. Propozim Plan i punës së Kuvendit për vitin 2018

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht që të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit e keni analizuar materialin e dërguar rreth kësaj pike përkatësisht Planit të Punës së Kuvendit për pjesën e mbetur të viti 2018, andaj e hapim debatin.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrah propozim Planin e Punës për vitin 2018 i cili si i tillë parasheh një varg aktivitete dhe raportimesh nga ana e Ekzekutivit të Komunës dhe në të njëjtën kohë në plan parashihet edhe mundësia e mbajtjes së ndonjë seance eventuale për ndonjë rast urgjent ose të jashtëzakonshëm që eventualisht mund të paraqitet gjatë asaj kohe, gjë e cila tregon gatishmërinë dhe vullnetin për punë. Ne konsiderojmë që në kuadër të këtij Plani është mirë të përfshihet edhe një informatë rreth shëndetësisë si dhe në muajin mars të parashihet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak, proces ky i natyrshëm që ndodh përgjatë një viti fiskal.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, duke parë se çfarë është propozuar, mendoj se është një Plan jo i plotë, i plogësht dhe një Plan i cili është marrë “copy past” nga vitet paraprake, megjithatë në esencë të rolit dhe objektivave që duhet të jenë në një Kuvend komunal ne mendojmë se nuk është, ngase t’ju them të drejtën ne kemi menduar një Plan më të fortë dhe më përmbajtësor, kështu që ne kemi një propozim, meqë Planin është përcaktues për punën që do të bëjë Kuvendi dhe duke dashur që Kuvendi të bëhet kreativ dhe me të vërtetë të trajtojë problemet që kanë qytetarët, e jo vetëm kur është në pyetje të miratohen çështjet që i procedon Ekzekutivi i Komunës madje shpeshherë ndoshta njëanshëm. Nuk dëshiroj të përmend sot se çfarë duhet të futet në Planin e punës së Kuvendit, por disa prej tyre patjetër duhet të ceken, shembull tani më veç po hymë në muajin mars dhe nuk e kemi planin e prokurimit, planin e auditimit që janë obligime ligjore, e shumë e shumë të tjera të cilat janë obligime ligjore t’i kemi në Plan të punës ne si Kuvend duke respektuar edhe afatet në këtë Plan.

Unë mendoj se ky propozim Plan nuk i plotëson kushtet, prandaj propozojmë që të keni vullnetin e mirë ku fillimisht të formohet një komision nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në këtë Kuvend, komision i cili për mbledhjen tjetër ta përgatitë vërtetë një plan pune i cili do të ishte udhërrëfyes për ne si këshilltarë në mënyrë që të vazhdojmë punën, andaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së mendojmë se kështu siç është propozuar ky Plan nuk mund të miratohet, por duhet të shtyhet për mbledhjen tjetër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, materiali është dërguar me kohë dhe e kemi shqyrtuar, mendoj se ky Plan nuk do të jetë statik ose i pandryshuar sepse sigurisht që gjatë vitit do të ketë seanca të ndryshme dhe do të ketë pika tjera të propozuara qoftë nga Ekzekutivi qoftë nga këshilltarët e Kuvendit. Sa i përket asaj që parafolësi e ceku, normal që do të ishte gjë e mirë që ky Plan të ishte më i kompletuar mirëpo më mirë do të ishte që ne sot të propozojmë pika dhe tema tjera për përfshirje në Plan dhe të njëjtat të miratoheshin sepse ne tani veç po hymë në muajin mars dhe pikat janë të caktuara në këtë dokument, përndryshe do të vonoheshim ngase nuk do të mund të miratohej ky Plan deri në muajin prill, gjë që do të ishte vonë. Unë mendoj se ky Plan më shumë është si pikë orientuese për këshilltarët rreth asaj se kur do të ketë seanca se sa që të jemi në dijeni se çfarë kërkesash – propozimesh sjellën nga Ekzekutivi ose qytetarëve apo edhe kërkesa të ndryshme që bëhen nga vet ky Kuvend, pra nuk mund të paragjykojmë por orientimin e kemi. Propozoj që në kuadër të Planit të punës, në fund vit, të përfshihet një raport – përmbledhje e punës së Kuvendit dhe Komiteteve të cilin e sjellë Kryesuesi i Kuvendit, pastaj do të ishte mirë të përfshihej edhe plani i prokurimit i cili nuk do të thotë se nuk ndryshon për shkak se kërkesat që vijnë nga terreni apo për shkak të ofertave të ndryshme, e që nuk është ndonjë dokument shumë i rëndësishëm të cilin ndoshta Ekzekutivi heziton ta sjellë, çështje për të cilën edhe në trajnimin e mbajtur na është thënë se Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë pjesë e planeve të Ekzekutivit, natyrisht jo për t'i ndryshuar ato por me qëllim që të kemi një orientim se ku do të investohet e gjëra të ngjashme, e që mendoj se edhe me plotësim ndryshimin e Statutit do të rregullohen disa gjëra.

Pra konsideroj se nëse nuk miratohet ky propozim Plan i punës, këshilltarët e Kuvendit nuk do të jenë në dijeni madje as kur e kanë pushim, por nëse vazhdojmë ashtu si e ceku këshilltari paraprak z.Bajram Ajeti, ne do të mbesim deri në muajin prill pa Plan të punës, mirëpo do të ishte mirë që nëse ka propozime të njëjtat të përfshihen në këtë Plan, nëse nuk ka propozime është e paarsyeshme të shtyhet për një seancë tjetër sepse ky dokument është marrë qe 7-8 ditë dhe ka mundur secili prej nesh të analizoj dhe të del me propozime. Ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së jemi që të miratohet ky propozim Plan duk përfshirë edhe propozimet tona që ishin Plan i prokurimit dhe raporti – përmbledhja e punës së Kuvendit dhe Komiteteve, si dhe pikat tjera të cilat mund të propozohen në vazhdim nga Grupet tjera të këshilltarëve.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së kemi propozime konkrete për përfshirje në kuadër të Planit të punës, e ato janë:

- propozimi për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive, nga DKRS
- plan i punës për Ekzekutivin, do të thotë raportim nga Drejtorët e Drejtorive
- informatë për inspektimin e bizneseve në Komunën e Podujevës, nga Drejtoria e Inspeksionit
- Informatë lidhur me gjendjen e pyjeve në Komunën e Podujevës
- informatë lidhur me dhënien e bursave për vitin 2018

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëgjuam diskutimet e parafolesve ku pati edhe propozime nga ana e tyre, pastaj nga dy Grupe të këshilltarëve u përkrah ky propozim, ndërsa nga këshilltari z.Bajram Ajeti pati vërejtje kinse ky Plan nuk i plotëson kriteret dhe është i vjetruar si dokument. z.Rafet Llapashtica e tha se ky Plan duhet të miratohet duke shtuar edhe dy propozimet e dhëna si dhe pati kërkesa konkrete këshilltarja z.Adelinë Stublla të cilat veç i lexoi. E përkrahi atë që ky Plan duhet të plotësohet dhe pasurohet edhe më shumë dhe natyrisht që i përkrahi edhe kërkesat dhe propozimet e këshilltarëve, andaj edhe jam që si i tillë të miratohet duke përfshirë edhe ato çështje të cilat vërtetë janë të nevojshme dhe për këtë nuk asgjë të keqe.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në këtë rend dite patëm formimin e një komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës kurse në Planin e punës nuk është paraparë formimi i një

komisioni të tillë për një akt kaq të rëndësishëm apo thënë ndryshe kemi të bëjmë me Statutin si akt themelor i Komunës, komisioni i cili do t'i sjell propozim ndryshimet statutare në këtë Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Pra përveç atyre që z.Adelinë Stublla i ceku, ne kemi edhe shumë propozime tjera për përfshirje në Planin e punës të cilat sigurisht që seancë pas seance do t'i shtrojmë për diskutim sepse kemi shumë çështje të cilat mendojmë se do të duhej të jenë në Plan.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, propozim vendimin së bashku me draft Planin e punës e keni marrë me kohë ku në nenin 2 të vendimit thuhet; *Kuvendi i Komunës përveç pikave të parapara në këtë Plan shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës*, pra do të thotë që ky Plan mund të plotësohet në seancat e radhës.

z.Avni Fetahu, theksoi, mendoj se do të ishte mirë që ne si të zgjedhur të popullit të japim një shembull të mirë sa i përket diskutimeve, pra ky Kuvend ka disa rregulla, ka foltoren dhe secili prej nesh mund të merr fjalën dhe të del këtu për të diskutuar, e jo të zhvillojmë biseda nga vendi dhe të krijohet pastaj një opinion kinse nuk është bërë asgjë sepse ne kemi një propozim Plan i cili sigurisht që për ne nuk konsiderohet si statik dhe i pa plotësuar ndër kohë me pika tjera të nevojshme ngase i njëjti len hapësirë për ndryshim plotësime gjë për të cilën janë në dijeni edhe këshilltarët që kanë qenë në mandatin e kaluar, pra është krejt e natyrshme që kohë as kohe rrjedhin informata, kërkesa dhe çështje tjera për shqyrtim dhe diskutim në këtë Kuvend, prandaj për ata jemi ne këtu, ndërsa të quhet si Plan i lodhët, i dobët etj, unë nuk e konsideroj ashtu për arsye se len hapësirë diskutimi për shumë çështje të cilat janë në interes për qytetarët.

z.Bajram Ajeti, theksoi, rreth asaj që parafolësi e tha se ky Plan ka hapësirë shumë, do të thotë se ka më pak Plan e më shumë hapësirë që mund të bëjmë në të ardhmen, kjo tregon se Plani nuk është ai që do të duhej të ishte dhe besoj që Ju nuk mund të bindeni asnjëherë për këtë nëse nuk janë të sinqertë dhe korrekt.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të nderuar ky Kuvend ka disa rregulla në bazë të të cilave funksionon dhe punon, konkretisht fjala është rreth diskutimeve, Rregullorja e Punës parasheh qartë mënyrën e marrjes së fjalës dhe diskutimeve nga ana e këshilltarëve, andaj i drejtohem parafolësit se për të njëjtën çështje nuk mund të merret fjala kaq shumë herë nga i njëjti këshilltarë, prandaj kërkoj nga të gjithë të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, përndryshe do të jem i detyruar të veproj unë pastaj, ose në të kundërtën nuk e lejoj një gjë të tillë.

Meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozim Planin e punës së Kuvendit për vitin 2018 duke përfshirë edhe propozimet e dhëna nga këshilltarët parafolës.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua propozim Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, duke përfshirë edhe propozimet e këshilltarëve: z.Avni Fetahu, z.Rafet Llapashtica dhe znj.Adelinë Stublla.

5. Kërkesa për ndihmë financiare e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi

“HANDIKOS” – Podujevë

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në radhë kemi kërkesën e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi “HANDIKOS” – Podujevë, e cila ka kërkuar mbështetje financiare me një shumë të caktuar për programin dhe aktivitetet e kësaj Shoqate për vitin 2018, kërkesën e keni marrë me kohë dhe keni pas kohë të analizoni, andaj fjala është për Ju.

z.Avni Fetahu, theksoi, kërkesa për ndihmë financiare e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi “HANDIKOS” – Podujevë, është kërkesë e arsyeshme, e artikuluar mirë, me projekte

konkrete gjatë vitit, me afate kohore, si dhe me rezultatet gjatë viteve që kemi lënë pas. Përkrahja me mjete financiare për këtë Qendër, për ne grupin e këshilltarëve të LDK-së nënkupton përkrahje për njerëz të vullnetit të mirë dhe zhvillimit të aftësive intelektuale si dhe motivim të grupeve të veçanta dhe me nevojë, andaj Grupi i këshilltarëve nga LDK e përkrahë këtë kërkesë dhe njëkohësisht konsiderojmë se në të ardhmen është e nevojshme të shqyrtohet edhe mundësia e përkrahjes me shuma më të mëdha.

z.Vendenis Lahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së në parim shprehë mbështetjen për ndarjen e mjeteve buxhetore për Organizatën Joqeveritare “Handikos”- Podujevë. Duke pasur parasysh numrin relativisht të madh prej rreth 900 personave të evidentuar nga kjo Organizatë, shuma e ndarë është goxha modeste dhe vështirë që mbulon nevojat elementare, andaj kërkoj nga institucionet komunale që këtë ndarje të mjeteve buxhetore të mos e shohin si kryerje të obligimit dhe ta lënë në harresë gjatë gjithë vitit. Komuniteti në fjalë ka vështirësi në qasje në hapësirat publike ku prej rreth 900 personave të evidentuar nga “Handikos”, rreth 100 prej tyre lëvizin me karrocë, prandaj duhet t’i kemi parasysh ata persona edhe në planifikimet infrastrukturore. Në Komunën tonë kemi mungesë të theksuar të pjerrinave të cilat do të mundësonin qasjen e lirë të atyre personave veçmas atyre të cilët lëvizin me karroca, pastaj rrugët dhe hapësirat publike nuk janë aq shumë të përshtatshme sepse kemi pjerrina të cilat nuk i përmbushin standardet për qasje të lehtë të këtyre personave ku ai standard është 5%, kurse edhe në ato pjerrina të pakta që janë në Komunën e Podujevës, përqindja është shumë e lartë. Po ashtu nga të dhënat që kemi marrë 28 persona vozitin autovetura, e që kjo me automatizëm na tregon që në Komunën tonë duhet të kemi më shumë vendparkigje për këta persona, ndërsa ne jemi në dijeni se kemi vetëm dy të tilla, tek Stacioni i Policisë dhe tek Posta, të cilat edhe ashtu fatkeqësisht shumicën e kohës janë të bllokuar nga persona tjerë që nuk i përkasin kësaj kategorie. Problem tjetër që e shohë për këtë kategori të personave është edhe punësimi i tyre, çështje e cila është shumë me rëndësi dhe që ndikon drejtpërdrejt edhe në mirëqenien psikofizike të tyre mirëpo është edhe obligim ligjor dhe institucional punësimi i personave të kësaj kategorie, e që sipas të dhënave që kemi, në administratën komunale janë rreth 210 persona të punësuar, kurse sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 10 të Ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, obligohet institucioni apo punëdhënësi që për çdo 50 të punësuar, 1 prej tyre duhet të jetë nga kategoria në fjalë.

Në sektorin publik kemi rreth 2000 persona të punësuar, kurse për ta përmbushur kriterin ligjor në këtë sektor do të duhej të ishin rreth 40 persona të punësuar nga kjo kategori, e që nga të dhënat që i kemi ky numër nuk është plotësuar dhe ka mungesë të hapësirës që ju jepet personave në fjalë, fjala është për institucionet publike, prandaj kërkojmë që kjo të merret parasysh dhe të ndërmarrin punë aktive në drejtim të përmirësimit të hapësirës për punë që iu ofrohet personave në fjalë. Gjithashtu çështje tjetër të cilën dëshiroj të theksoi është se në bazë të informacioneve që posedojmë, Komuna e Podujevës, në mandatet e kaluara nuk është që ka ndarë mjete buxhetore për Organizatat simotra me atë të “Handikos” siç janë ajo e autizmit, Organizata e Invalidëve të luftës apo ajo me sindrom down, prandaj mendojmë dhe kërkojmë që Komuna duhet të tregohet e kujdesshme dhe të ndaj mjete buxhetore edhe për këto Organizata sepse nevojat janë të mëdha, kështu që shpresoj që institucionet komunale ta kenë parasysh këtë kërkesë timen, e që besoj se është e të gjithëve, madje edhe qytetarët besoj se mirëpresin këtë iniciativë, dhe të kemi rezultate në fund.

z.Fatmir Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së edhe në të kaluarën e ka mbështetur propozimet për mbështetje financiare për këtë kategori. Pa dashur të përsërisë ato që u than nga parafolësit, sepse besoj se shumica e gjërave veç u than. Mendojmë që në të ardhmen duhet të shikohet mundësia që kjo kategori e njerëzve të ndihmohet me shuma më të mëdha,

natyrisht varësisht buxhetit. Kjo kategori në Komunën numëron rreth 900 persona ku rreth 150 prej tyre janë fëmijë, 200 janë me kushte të rënda dhe nevoja shumë të veçanta e që shumica prej tyre jetojnë në vende rurale të cilët besoj që meritojnë një trajtim mirë. Pra e mbështesim këtë kërkesë dhe çdo herë jemi për një mbështetje të tillë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë kërkesë.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua kërkesa e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi "HANDIKOS" – Podujevë për mbështetje financiare për realizimin e programit vjetor dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2018.

6. Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale

- Rishqyrtimi sipas rekomandimeve të MF-së dhe MAPL-së

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, para vetës keni këtë pikë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me rishqyrtimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale. Sa për njoftim, pas përfilljes së të gjitha procedurave përkatëse ligjore, Rregullorja në fjalë është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës mbajtur më 19 shtator 2017. Në zbatim të dispozitave ligjore, akti i cekur më datë 20 shtator 2017 është proceduar ose dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL, për shqyrtim administrativ, gjegjësisht për vlerësim të ligjshmërisë. MAPL, aktin e cekur e ka proceduar në Ministrinë e Financave – MF, Ministri kjo kompetente për shqyrtim administrativ të aktiviteteve të kësaj natyre. Më datë 23 tetor 2017 Ministria e Financave përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me shkresë përcjellëse e cila ju është dërguar me materialin e kësaj pike, ka kthyer vlerësimin e ligjshmërisë sipas të cilit ashtu siç e keni vërejtur edhe Ju, nga Komuna e Podujevës është kërkuar përmbushja e disa rekomandimeve në mënyrë që Rregullorja në fjalë të fillon së zbatuari. Pra një gjë duhet pasur parasysh se fjala është për rishqyrtimin e aktit duke marrë në konsideratë vetëm rekomandimet e bëra nga Ministria e Financave, përndryshe Rregullorja është shqyrtuar dhe miratuar në këtë Kuvend, pra kërkohet që vetëm rekomandimet e theksuara në shkresë të aplikohen në dokumentin e cekur, kurse nuk lejohen kurrfarë ndryshimesh tjera.

Vlen të ceket se rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave kanë ndikim në dy aspekte;

1-mund të jetë negativ në kuptimin e asaj që do të zvogëlohen të hyrat vetanake të planifikuara të Komunës e që pastaj ndikon drejtpërsëdrejti në zvogëlimin e buxhetit të Komunës. ndërsa aspekti, 2-mund të themi se është rekomandim pozitiv për arsye se ndikon drejtpërsëdrejti tek qytetarët dhe është në interes të tyre sepse lehtësohen punët sa i përket aspektit financiarë dhe procedural për rregullimin e dokumentacionit përkatësisht transaksioneve dhe regjistrimit të pronave të tyre, e që ky aspekt mund të vlerësohet si interes i qytetarëve por edhe i komunës sepse ndikon që qytetarët të rregullojnë më lehtë të gjitha transaksionet që ndërlidhen me pronën, andaj për këtë dhe arsye tjera kërkohet që rishqyrtimi i kësaj Rregulloreje sipas rekomandimit të Ministrisë, të mbështetet nga Ju këshilltarë/e të nderuar të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të mundësohet zbatimi i saj sa më shpejt që të jetë e mundur.

z.Avni Fetahu, theksoi, duke marrë parasysh përbërjen e re të këtij Kuvendi, e shoh të rrugës që edhe unë të bëjë një njoftim lidhur me Rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale, akt ky i harmonizuar me ligje dhe aktet nënligjore duke përfshirë edhe së fundmi edhe me ligjin për kundërvajtje. Rregullores në fjalë natyrisht se i ka paraprirë edhe diskutimi dhe debati publik me

qytetarë dhe grupe të interesit, ku pastaj është diskutuar dhe shqyrtuar edhe me këshilltarët e Kuvendit nga përbërja e kaluar, pastaj ka qenë forma e diskutimit edhe përmes postës elektronike ku ka qenë zyrtari përkatës në atë kohë. Gjatë diskutimit dhe debatit publik janë marrë propozime nga qytetarë, komuniteti i biznesit, këshilltarët e Kuvendit etj, ku të gjitha ato të arsyeshmet janë inkorporuar në dokumentin e Rregullores në fjalë. Vlen të theksohet se sa i përket bizneseve janë bërë disa ndryshime dhe lehtësira ku subjektet e reja afariste pronar të të cilave janë femra, lirohen nga taksa komunale për vitin në të cilin regjistrohen dhe dy vitet vijuese, pastaj subjektet e reja prodhuese dhe bujqësore si dhe bizneset e reja me kapital nga diaspora, lirohen nga taksat komunale për vitin në të cilin regjistrohen dhe tri vitet vijuese, gjithashtu taksat komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe për shërbime profesionale për të gjitha kategoritë janë të propozuara të lirohen 50%.

Rregullorja është korrigjuar në aspektin profesional edhe nga zyra ligjore, dhe natyrisht parashihet, ashtu siç e cekur edhe drejtori parafolës, të inkorporohen edhe rekomandimet e Ministrisë përkatëse. Kështu që Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrah Rregulloren në fjalë përkatësisht inkorporimin e rekomandimeve dhe e konsideron si lehtësim për bizneset dhe qytetarët në përgjithësi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, natyrisht që rekomandimin e dy Ministrive përkatëse e kemi marrë me material. Tek neni 4 ku i referohet zbritjes së taksave për certifikatën mbi statusin martesor ku nga 3 euro është rekomanduar të zbritet në 2 euro, nuk jam në dijeni se a është obligim ligjor të zbritet apo si rregullohet kjo çështje. Si do që të jetë ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim këtë rregullore dhe harmonizimin e saj sipas rekomandimeve të Ministrive të linjës.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e mbështesim këtë Rregullore dhe rekomandimet e Ministrive, meqë, siç u tha nuk ka hapësirë të bëhen ndryshim plotësim tjera përveç rekomandimeve të Ministrisë së Financave, atëherë të njëjtat të inkorporohen dhe të vazhdohet me punë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se të gjitha sqarimet u dhanë nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe nga këshilltarët parafolës, mirëpo nëse ka këshilltar/e tjerë të interesuar për të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përkatësisht rishqyrtimi sipas rekomandimeve të Ministrisë së Financave dërguar përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresën nr.43-1200/7 dt.23.10.2017

7. Të ndryshme

znj.Lirika Maliqi, theksoi, për mbledhjen e radhës, si pikë shtesë kemi menduar që është mirë të formohet komisioni për ndarjen e shtëpive të ndërtuara për familjet që jetojnë në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, për mbledhjen e radhës si pikë shtesë kërkojmë raportin e prokurimit për periudhën qershor – dhjetor 2017.

z.Avni Islami, theksoi, shfrytëzoj rastin që para këtij Kuvendi ta ngris një shqetësim i cili besoj që nuk është vetëm shqetësim i imi por i të gjithë banorëve Llapjan. Fjala është për funksionalizimin e Spitalit në Podujevë, çështje për të cilën në buxhetin e Qeverisë së Kosovës nuk janë ndarë mjetet e nevojshme e që është dashtë të ndahen, madje duke përfshirë edhe një pjesë të aparaturave dhe personel për këtë Spital, e që deri tani e rrugës do të ishte që të ishin në funksion të Spitalit.

Propozimi im është që Komuna e Podujevës me të gjitha strukturat e veta të shfrytëzoj mekanizmat që në një mënyrë të bëjë presion ndaj Qeverisë aktuale të Kosovës që në muajin qershor të ndaj mjetet financiare në mënyrë që Spitali i Podujevës të jetë funksional. Këtë e them me arsyetim se kur në qyteza më të vogla siç janë Vushtrria ose Ferizaj i kanë të funksionalizuar Spitale të tilla, atëherë përse edhe ne Komuna e Podujevës të mos kemi të funksionalizuar një Spital i cili do t'i plotësonte nevojat dhe besoj që personeli i mjekëve do të ishte i mjaftueshëm nga QKUK që të autorizohen dhe të jetë funksional. Për fund uroj që ne të gjithë së bashku këtu të adresojmë këtë problem dhe brenda këtij viti të funksionalizohet Spitali i Podujevës.

z.Bajram Ajeti, theksoi, tani ne jemi duke përjetuar një dimër me acar dhe Komunën tonë e ka gjetur totalisht të papërgatitur, kështu që kërkojmë që në mbledhjen e radhës të jepet një raport, përse erdhi deri tek kjo gjendje, cilat janë arsyet dhe shkaqet.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, e kërkonte fjalën me të vetmin qëllim që kjo mbledhje të mos përfundojë pa i falënderuar subjektet politike pjesëmarrëse në Kuvend që përmes përfaqësuesve të tyre në Këshillin organizativ për festimin - shënimin e dhjetëvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe zbulimit të Shtatores së Heroit të Kosovës 'Ali Ajeti'. Pra publikisht këtu para Juve i falënderoj përfaqësuesit e dërguar nga ana Juaj, për punën e mirë që kanë bërë në atë Këshill, me rastin e shënimit të dhjetëvjetorit të shpalljes së Pavarësisë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:05

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0015561/18
Podujevë,
28 shkurt 2018

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi